



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.57/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Selma Abdiji, nga subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, të paraqitur kundër, Duda Baljes, Admir Aljilji dhe Behar Brenoli, kandidatët nga koalicioni Social Demokratska Unija (SDU)- Nasha inicijativa, me seli në Prizren për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 26.09.2025, merr këtë,

V E N D I M

HEDHEN TË PASAFATSHME ankesat ZL.Anr.57/2025 e datës 24.09.2025 dhe ZL.Anr.64/2025 e datës 25.09.2025 të paraqitura nga Selma Abdiji, nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, të paraqitur kundër Duda Balje, Admir Aljilji dhe Behar Brenoli, kandidatë nga koalicioni Social Demokratska Unija (SDU) - Nasha inicijativa, me seli në Prizren për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 24.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë ZL.Anr.57/2025 nga Selma Abdiji, nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren me te cilën pretendon se gjatë fushatës zgjedhore më 16.09.2025 në orën 19:30, një postim në profilin e Duda Baljes në Facebook dhe në faqen zyrtare të Social Demokratska Unija, gjatë fushatës zgjedhore, kandidatët e listës së koalicionit SDU-NAŠA për Komunën e Prizrenit, Duda Balje dhe Admir

Aljilji, kanë paraqitur në rrjetet sociale (Facebook) fillimin e realizimit të projekteve infrastrukturore të financuara nga buxheti i Komunës së Prizrenit, si një arritje e tyre politike. Në postime janë përdorur fotografi ku shihen kandidatët, dhe në vetë postimin është etiketuar edhe drejtori i Drejtorisë për shërbime publike të Komunës së Prizrenit, çka krijon përshtypjen e identifikimit politik me burimet publike dhe aktivitetet e organeve shtetërore. Parashtruesi i ankesës thekson se këta kandidatë, duke keqpërdorur burimet shtetërore/komunale dhe pozitat zyrtare, kanë përdorur aktivitete publike për qëllime të promovimit zgjedhor dhe ndikimit te votuesit. Sipas parashtruesit të ankesës postimet janë shpërndarë nga profili personal i Duda Baljes dhe faqja zyrtare e Social Demokratska Unija (SDU), duke arritur kështu një dukshmëri të madhe dhe duke ndikuar te votuesit. Parashtruesi i ankese thekson se paraqitja dhe reklamimi i punëve publike në infrastrukturë si arritje politike e kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore tregojnë qartë përzierjen e burimeve shtetërore/komunale me aktivitetet zgjedhore dhe se përdorimi i personave zyrtarë (drejtorët e shërbimeve publike) dhe i projekteve zyrtare për promovim politik ndikon në barazinë e kushteve për kandidatët dhe në drejtësinë e procesit zgjedhor.

Këto veprime sipas parashtruesit të kishin për qëllim të ndikonin te votuesi duke i paraqitur realizimin e projekteve publike si rezultat i veprimtarisë politike të të akuzuarve. Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelja e dispozitave ligjore/normative dhe kërkon ndalimin e keqpërdorimit të burimeve publike dhe pozitës zyrtare për qëllime të promovimit zgjedhor. Andaj kërkon nga PZAP-i që të iniciojë procedurën e hetimit të këtij rasti dhe të konstatojë shkeljen e mundshme të ligjeve dhe kodit të sjelljes së kandidatit gjatë fushatës zgjedhore, të marrë masat e duhura kundër kandidatit në përputhje me ligjin aktual zgjedhor, të parandalojë keqpërdorimin e mëtejshëm të votave të votuesve, ku me aktivitetet politike krijohet përshtypja e identifikimit politik me burimet publike dhe aktivitetet e organeve shtetërore.

Si dëshmitë i ka bashkëngjitur ankesës CD që përmban Screenshots (foto) të postimeve në profilin e Duda Baljes në Facebook dhe në faqen zyrtare të Social Demokratska Unija (SDU), video regjistrime nga profili i Duda Baljes në facebook dhe faqja zyrtare e Social Demokratska Unija dhe lidhje (URL) të postimeve të lartpërmendura.

Po ashtu me datë 25.09.2025 ne PZAP, është parashtruar një ankesë tjetër me numër ZL.Anr.64/2025 nga Selma Abdiji, nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren me të cilën pretendon se gjatë fushatës zgjedhore më 19.09.2025 rreth orës 17:00, postim në profilin e Facebook-ut të Duda Baljes dhe faqen zyrtare të Facebook-ut të Socijal

Demokratska Stranka (SDU), gjatë fushatës zgjedhore, kandidatët e listës partiake të Socijal Demokratska Stranka (SDU) për Komunën e Dragashit, Duda Balje dhe Behar Brenoli, me anë të postimeve në rrjetet sociale (Facebook), paraqitën fillimin e punëve infrastrukturore të financuara nga buxheti i Komunës së Dragashit si arritje personale e tyre, ku në postime janë përdorur fotografi ku ndodhen kandidatët, duke krijuar kështu një përshtypje politike të identifikimit me mjetet dhe aktivitetet publike të organeve shtetërore. Sipas parashtruesit të ankesës këta kandidatë, në këtë mënyrë, kanë keqpërdorur burimet publike (shtetërore/komunale) dhe aktivitetet zyrtare, për qëllime të promovimit zgjedhor dhe ndikimit tek elektorati. Postimet janë bërë në profilin personal të Duda Baljes dhe në faqen zyrtare të Socijal Demokratska Stranka (SDU), duke i dhënë kështu një dukshmëri dhe ndikim më të madh tek votuesit. Parashtruesi i ankesës thekon se paraqitja ose atribuimi i punëve infrastrukturore publike si arritje politike e kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore paraqet një përzierje të qartë të aktiviteteve publike/komunale me aktivitetet zgjedhore, ndërsa postimet kishin për qëllim të ndikonin tek elektorati duke paraqitur realizimin e projekteve publike si rezultat i veprimtarisë politike të kandidatëve.

Sipas parashtruesit të ankesës ndalohet keqpërdorimi i burimeve publike dhe pozitës zyrtare për qëllime të promovimit zgjedhor. Si provat që i bashkëngjiten ankesës: CD me prova që përmban: Screenshots (pamje të ekranit) të postimeve në profilin e Facebook-ut të Duda Baljes dhe faqen zyrtare të Socijal Demokratska Stranka (SDU), Video regjistrime të profilit të Facebook-ut të Duda Baljes dhe faqes zyrtare të Facebook-ut të Socijal Demokratska Stranka (SDU), Lidhjet (link-et) e përmendura në postime, <https://www.facebook.com/share/p/1CzJ6CMaHX/>, <https://www.facebook.com/share/p/1BXQK72wFo/>

Parashtruesi i ankesës propozoj që të fillojë një procedurë për hetimin e këtij rasti dhe të konstatohet shkelja potenciale e ligjit dhe e kodit të sjelljes së kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore, të ndërmerren masat e duhura kundër kandidatëve në përputhje me ligjin aktual zgjedhor, të parandalohet keqpërdorimi i mëtejshëm i votave të votuesve, ku me aktivitetet politike krijohet përshtypja e identifikimit politik me mjetet publike dhe aktivitetet e organeve shtetërore.

Në përgjigjen në ankesë lidhur rastin ZL.Anr 57, nga subjekti politik SDU, theksohet se sipas Rregullores nr. 01/2025 për procedurën e paraqitjes së ankesave në PZAP, ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara gjatë fushatës zgjedhore, duke përfshirë çështjet për fushatën, mediat dhe sjelljen e subjekteve politike, duhet të paraqiten brenda 48 orëve nga momenti kur

ka ndodhur shkelja. Aktiviteti për të cilin bëhet fjalë në ankesë ka ndodhur më 16.09.2025, Ankesa është paraqitur më 24.09.2025, pra tetë (8) ditë pas aktivitetit të kontestuar. Duke qenë se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor, ajo është e pasafatshme. Rrjedhimisht, ankesa nuk i plotëson kushtet themelore procedurale për t'u shqyrtuar nga PZAP. Në bazë si më sipër, propozojmë që PZAP të hedhë poshtë ankesën si të pabazuar dhe të pasafatshme, në përputhje me Rregulloren nr. 01/2025.

Lidhur me ankesën ZL.Anr.64/2025, subjekti politik SDU nuk ka ofruar përgjigje në ankesë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.57/2025 të datës 24.09.2025 dhe ZL.A.nr.64/2025 të datës 25.09.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.57/2024, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj te gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

**-Ankesat janë të pasafatshme.**

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Selma Abdij, nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, e paraqitur kundër Duda Balje dhe Admir Aljilji, kandidatë nga koalicioni Social Demokratska Unija (SDU) - Nasha inicijativa, me seli në Prizren, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-*

së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: “ *Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”.*

Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar, pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese lidhur me ankesën ZL.Anr.57/2025 shkelja e supozuar dhe data e publikimit të fotove në rrjetin social facebook ka ndodhur me datë 16.09.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 24.09.2025, ndërsa lidhur me ankesën ZL.Anr.64/2025 shkelja e supozuar dhe data e publikimit të fotove në rrjetin social facebook ka ndodhur me datë 19.09.2025, që do të thotë se të njëjta pra të dy ankesat në fjalë janë të paraqitura pas afatit ligjor, me çka vërtetohet se ankesat e ankuesit janë paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Paneli ka gjetur se që të dy ankesat janë parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të LZP-së, dhe nenet 9 paragrafi 5 dhe 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.57/2025 datë 26.09.2025



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi*